
STATUT
I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
" Zeka & Musaj Legal Consulting " Sh.p.k

Ortakët e shoqërisë "Zeka & Musaj Legal Consulting" Sh.p.k. sot me datë 04.03.2021 kanë vendosur të përpilojnë Statutin e mëposhtem të një shoqërie me përgjegjesi të kufizuar (me poshtë "Shoqëria"), aktivitetet e secilës do të rregullohen nga legjislacioni shqiptar në fuqi, veçanërisht nga Ligji nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregëtarët e Shoqëritë Tregëtare" i ndryshuar, Ligjit Nr. 9723, date 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

KAPITULLI I
FORMA, EMËRTIMI, OBJETI, ZYRA QENDRORE, KOHËZGJATJA

Neni 1
Forma

Shoqëria " Zeka & Musaj Legal Consulting " Sh.p.k në vijim "Shoqëria" krijohet në formën e një shoqërie me përgjegjesi të kufizuar dhe veprimtaria e saj rregullohet me anë të këtij Statuti dhe Aktit të Themelimit.

Shoqëria vepron sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

Akti i Themelimit dhe Statuti janë në përputhje me legjislacionin shqiptar, që ka karakter të detyrueshëm, ndërsa çështjet që nuk janë shprehimisht të parashikuara në to, plotësohen nga legjislacioni shqiptar.

Neni 2
Emërtimi


Emërtimi i Shoqërisë është "Zeka & Musaj Legal Consulting" Sh.p.k

Neni 3
Objekti i Shoqërisë

Shoqëria ka si objekt veprimtarie:

Ofrim i shërbimeve ligjore për individët, personat fizik dhe juridikë shqiptarë e të huaj; ndihmë e konsulencë ligjore në fushën penale, civile, tregëtare, administrative, familjare, të punës, të të miturve, të doganave, të tatim taksave, të pushtetit vendor, të ndërtimit, të shërbimit civil, të financave, të vlerësimit të pasurive të paluajtshme, të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të topografisë, hartografisë, mjeksisë në përgjithësi, të të drejtës ndërkombëtare publike dhe private, ekspertiza në fusha të ndryshme, në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Përfaqësimin e personave fizike a juridike, vendas a të huaj në institucione të ndryshme publike e private si dhe përfaqësim në të gjitha shkallët e gjyqësorit, në territorin e Republikës së Shqipërisë.



Konsulencë financiare e fiskale, përfshirë edhe hartimin e pasqyrave financiare, përgatitjen e list-pagesave etj; kryerjen e çdo veprimtarie tjetër të lejuar nga ligji për profesionin e avokatit dhe legjislacioni tjetër në fuqi;

Marrjen pjesë në projekte që kanë si qëllim njohjen dhe implementimin e legjislacionit ndërkombëtar e veçanërisht atij të BE-së në legjislacionin e brendshëm në kuadrin e procesit të integritimit euroatlantik të vendit;

Marrjen pjesë në projekte që kanë si qëllim zbatimin e legjislacionit në fuqi, si dhe të ndihmojë nëpërmjet trajnimeve juriste dhe ekspertë të fushave përkatëse në njohjen, interpretimin dhe zbatimin e akteve normative; në përmirësimin e legjislacionit në përgjithësi, dhe atij të organizimit e funksionimit të institucioneve të sistemit të drejtësisë në veçanti;

Të ndihmojë subjektet e biznesit në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me pajtim, duke bërë të njohura edhe praktikat ndërkombëtare të arbitrazhit, për zgjidhjen e konflikteve tregtare.

Neni 4 Zyra Qendrore

Zyra qendrore/Selia e shoqërise në territorin e Republikës së Shqipërisë është në adresën:

Njesia Administrative Nr. 5, Rruga "Sulejman Delvina", Pallati Nr. 14, Hyrja 1, Kati 1, Apartamenti Nr.1, Zona Kadestrale Nr. 8270, Tiranë.

Shoqëria mund të zhvillojë veprimtarinë e saj ekonomike në të gjithë territorin e Shqipërisë si edhe jashtë saj duke hapur degë dhe/ose zyra përfaqësimi, filiale, agjenci etj. në qendra të tjera administrative në përputhje me legjislacionin e vendeve në të cilat ato hapen.

Neni 5 Kohëzgjatja

Shoqëria themelohet për një kohëzgjatje të pacaktuar duke filluar nga dita e regjistrimit të saj.

Neni 6 Rregjimi juridik i Shoqërisë

Shoqëria udhëhiqet nga parimet e ekonomisë së tregut dhe ka për qëllim fitimin. Ajo respekton parimin e reciprocitetit.

Ajo është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (SHPK). Veprimtaria e saj i nënshtrohet dispozitave të Aktit të Themelimit, Statuti si dhe dispozitave të legjislacionit në fuqi. Me vendim të Asamblese së Përgjithshme, Shoqëria mundet që të ndryshojë rregjimin juridik të saj në përputhje me dispozitat ligjore që do të jenë në fuqi si dhe në përputhje të plotë me dispozitat e Aktit të Themelimit dhe të Statutit të saj, duke bërë edhe përshtatjen e tyre sipas ndryshimeve përkatëse.

Shoqëria do të ketë vulën e saj.

Neni 7 Të drejtat dhe detyrimet e ortakëve

Ortakët mbajnë përgjegjësi për humbjet e shoqërise deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara. Pasuritë e krijuara nga Shoqëria gjatë aktivitetit të saj janë në pronësi të Ortakëve themelues të shoqërisë në përpjestim të drejtë me kuotat që zotërojnë.

Ato (pasuritë) mund të tjetërsohen, të jepen me qira, të lihen peng e hipotekë me miratimin e Ortakëve.

Ortakët japin kontributin në para apo në natyrë, sipas mënyrave dhe afateve të përcaktuara në statut. Ata përgjigjen ndaj shoqërisë personalisht dhe në mënyrë solidare për demet e shkaktuara nga mospermbushje e këtyre detyrimeve apo nga permbushja e tyre përtej afateve përkatëse.

Personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë informojnë ortakët për ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare, dhe me kërkesën e tyre, duhet t'u venë në dispozicion llogaritë vjetore, përfshirë llogaritë e konsoliduara, raportet për gjendjen dhe ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare, raportet e organeve drejtuese apo të ekspertëve kontabel të autorizuar.

Gjatë ushtrimit të të drejtave, ortakët veprojnë duke marrë parasysh interesat e shoqërisë.

Ortakët respektojnë detyrimet që burojnë nga Akti i Themelimit dhe Statuti.

Neni 8

Abuzimi i ortakëve ndaj shoqërisë

Ortakët e shoqërisë tregtare, që kryejnë një apo më shumë nga veprimet ose mosveprimet vijuese, përgjigjen personalisht e në mënyrë solidare për detyrimet e shoqërisë, me të gjithë pasurinë e tij nëse:

- a) Abuzojnë në formën e shoqërisë tregtare për arritjen e qëllimeve të paligjshme;
- b) Trajtojnë pasuritë e shoqërisë tregtare si të ishte pasuria e tij;
- c) Në çastin që kanë marrë apo duhet të kishin marrë dijeni për gjendjen e paaftësisë paguese të shoqërisë, nuk marrin masat e nevojshme, për të siguruar që shoqëria, në varësi të llojit të veprimtarisë të ushtruar, të ketë kapitale të mjaftueshme, për të përmbushur detyrimet e marra përsiper ndaj palëve të treta.

KAPITULLI II

KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, NDARJA E PJESVE TE KAPITALIT

Neni 10

Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 lekë. Kapitali i shoqërisë ndahet në dy kuota dhe pjesmarrja e ortakëve themelues në kapitalin e shoqërisë është si më poshtë:

Ortakja Themeluese Znj. Fabiola Zeka, shtetase shqiptare, e datëlindjes 23.04.1990 e lindur në Tepelenë dhe banuese në Tiranë, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës e letërnjoftimit Nr. 036494848 dhe Nr. Personal J05423077V, ka 1 (një) kuotë të përbërë nga 50 (pesëdhjetë lekë), duke përfaqësuar 50 % (pesëdhjetë për qind) të kapitalit.

Ortakja Themeluese Znj. Albana Musaj, shtetase shqiptare, e datëlindjes 24.08.1980, lindur në Tiranë dhe banuese në Tiranë, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtëse e letërnjoftimit Nr. 034754733 dhe Nr. Personal I05824121G, ka 1 (një) kuotë të përbërë nga 50 (pesëdhjetë lekë), duke përfaqësuar 50 % (pesëdhjetë për qind) të kapitalit.

Neni 11

Rritja e Kapitalit Themeltar

Kapitali themeltar mund të rritet pa kufi në çdo moment një ose disa herë, me vendim të asamblese së ortakëve, të cilët përfaqësojnë të paktën $\frac{3}{4}$ (tri të katërtat) e kapitalit të shoqërisë.

Në rast rritje të kapitalit dhe shoqëria ka më tepër se një ortak, të gjithë ortakët kanë të drejtë të nënshkruajnë rritjen në raport me pjesët e kapitalit të zotëruar. Në rast se disa nga ortakët nuk e ushtrojnë këtë të drejtë, pjesët e tyre mund të nënshkruhen nga ortakët e tjerë proporcionalisht me pjesmarrjen respektive.

Neni 12

Zvogëlimi i kapitalit themeltar

Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin themeltar me vendim të Asamblesë së Ortakëve, me votën pro të ortakëve që zotërojnë të paktën $\frac{3}{4}$ (tri të katërtat) e kapitalit themeltar.

Zvogëlimi i kapitalit përballohet nga secili prej ortakëve në propocion me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre.

Neni 13

Modalitete të përfitimit dhe transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- d) dhurimit;
- e) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Neni 14

Transferimi i pjesve te kapitalit dhe e drejta e parablerjes

Kontrata e kalimit të kuotës bëhet me shkrim dhe vetëm me akt noterial dhe në bazë të formaliteteve të vendosura nga Administratorët. Kalimi i kuotës i njoftohet shoqërisë ne seline e saj ligjore.

Pjesët e kapitalit janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

Në rast transferimi të pjesve të kapitalit në çdo lloj forme në favor të personave të tjerë nga ata të parashikuar me sipër, duke përfshirë dhe dhurimin, ortakët e tjerë gëzojnë të drejtën e parablerjes mbi këto pjesë të kapitalit.

Në një rast të tillë, ortaku që do të transferojë pjesët e tij të kapitalit duhet të njoftojë ortakët e tjerë me leter rekomandë me konfirmim marrje në dorezim, mbi synimin për shitjen, çmimin kushtet, modalitetet, emrin e blesit dhe afatet e transferimit. E drejta e parablerjes i referohet të gjitha pjesëve të ofruara për shitje.

Ortakët do të kenë në dispozicion 30 (tridhjetë) ditë nga marrja e letrës rekomandë me konfirmim marrje në dorezim, për t'i komunikuar ortakut që transferon pjesët e kapitalit synimin e për të ushtruar ose jo të drejtën e parablerjes. Në rast se ata nuk përgjigjen në afatin e caktuar, prezumohet se kanë hequr dorë nga e drejta e tyre e parablerjes.

Në rast se oferta pranohet nga disa ortakë pjesët e kapitalit të ofruar nga ortaku që transferon pjesët e kapitalit, do të ndahen nga ortakët pranues, në masë proporcionale me pjesët që ata zoterojnë, përveç rastit kur ka një marrëveshje të ndryshme ndërmjet paleve. Në asnjë rast, pranuesi i ofertes nuk mund të ushtrojë pjesërisht të drejtën e parablerjes.

Në rast se nuk ushtrohet e drejta e parablerjes, pjesët e kapitalit mund të transferohen të treta sipas marrëveshjes së bere.

KAPITULLI III ASAMBLEJA, ADMINISTRATORET DHE EKSPERTI KONTABEL



Neni 15 Asambleja e Përgjithshme dhe kompetencat e saj

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- d) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;



j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;

k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;

l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Vendimet e marra nga asambleja, detyrojnë edhe ortakët që mungojnë ose kundërshtojnë, të cilët kanë të drejtën e ankimit sipas afateve dhe kushteve të parashikuara me ligj.

Neni 16 **E drejta e pjesëmarrjes dhe e votës**

Vota e ortakut vlen në raport me pjesën e kapitalit që zoteron.

Ortaku i cili është në vonese në likuidimin e kuotes së tij, për efekt të likuidimit të kontributit në shoqëri apo të rritjes së kapitalit themeltar, nuk mund të marrë pjesë në vendim-marrjen e shoqërisë.

Çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjetër jo-ortak, i pajisur me prokurë me shkrim, prokurë kjo e cila duhet të ruhet nga shoqëria.

Prokura mund të jepet vetëm për një mbledhje asambleje. Prokura ka efekt edhe për mbledhjen e asamblese, që kanë të njëjtin rend dite.

Përfaqësimi nuk mund t'i jepet administratorit, ekspertit kontabel apo revizoreve të emeruar.


Neni 17 **Thirrja e Asamblesë**

Asambleja e ortakëve thirret të pakten një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar për miratimin e bilancit, të raportit të Administratorit dhe/ose ekspertit kontabel si dhe inventarit.

Asambleja mund të thirren në çdo moment nga një prej Administratorëve, ose nga eksperti kontabel (nese është emeruar), ose nga likuidatori/likuidatorët, si dhe prej një ose nga ortakët që përfaqësojnë të pakten 5% (pese për qind) të kapitalit themeltar.

Asambleja duhet të thirret nëpërmjet njoftimit me leter rekomande ose në mënyrë elektronike, që duhet të dërgohet ortakëve në adresën që rezulton e deklaruar në shoqëri të pakten 15 (pese mbledhjet) dite para ditës së caktuar për Mbledhjen.

Njoftimi duhet të përmbajë informacionin mbi mbledhjen, mbi rendin e ditës që do të trajtohet dhe për të cilat do të merret vendimi, mbi vendin, orën dhe datën e mbledhjes.



Asambleja do te thirret dhe mblidhet rregullisht dhe pa respektimin e formaliteteve te njoftimit, ne rast se jane te pranishem ortaket qe perfaqesojne te tere kapitalin themeltar dhe nuk jane kunder kesaj parregullsie.

Neni 18 **Zhvillimi i mbledhjeve te asamblesë**

Mbledhja e asamblese do te drejtohet nga administratori dhe ne rast te mungeses se tij ose te ndonje pengese, nga personi i emeruar nga asambleja.

Vendimet e asamblese do te fiksohen ne procesverbalet qe do te mbahen nga Kryetari dhe Sekretari i mbledhjes, te percaktuar nga asambleja.

Kryetari i mbledhjes ka detyren per te konstatuar mbledhjen e rregullt te asamblese, te sigurohet per identitetin dhe legjitimitetin e personave present, te drejtoje dhe rregulloje zhvillimin e mbledhjes dhe te sigurohet dhe paraqese rezultatet e votimit.

Mbledhja e asamblese mund te zhvillohet edhe ne vende te ndryshme, me lidhje audio ose video dhe kjo do te realizohet ne kushtet e meposhtme, te cilat duhet te permenden ne procesverbalin e mbledhjes:

- Te jene present ne te njejtin vend, kryetari dhe sekretari i mbledhjes, te cilet do te kujdesen per formen dhe nenshkrimin e procesverbalit.
- T'i lejohet kryetarit te mbledhjes qe te sigurohet per identitetin dhe legjitimitetin e pjesemarrësve, te organizoje zhvillimin e mbledhjes, te konstatoje dhe paraqese rezultatet e votimit.
- T'i lejohet personit qe mban procesverbalin per te perceptuar saktesisht veprimet e asamblese, te cilat duhet te regjistrohen
- T'i lejohet pjesemarrësve qe te nderhyjne ne diskutim dhe votim mbi argumentat e rendit te dites, si dhe te shikojne, te marrin dhe te transmetojne dokumenta.
- Te jene percaktuar ne njoftimin e mbledhjes se asamblese, vendet audio dhe video te lidhura nen kujdesin e shoqerise, ne te cilat pjesemarrësit mund te nderhyjne, duke quajtur se mbledhja eshte zhvilluar ne vendin ku ndodhen kryetari dhe sekretari, nese jane emeruar te tille.


Ne te gjitha vendet me lidhje audio dhe/ose video, ne te cilat do te mbahet mbledhja, duhet te vihet ne dispozicion fleta e prezences ne mbledhje.

Neni 19 **Kuorumi dhe shumica per vendimarrja**

Asambleja e ortakeve vendos me voten e ortakeve qe perfaqesojne te pakten $\frac{3}{4}$ e kapitalit te shoqerise, ne rast te marrjes se vendimeve me shumice te cilesuar. Ne kete rast, duhet te jene present ne mbledhje, ose te votojne nepermjet mjeteve elektronike/shkrese, ortaket qe zoterojne me shume se numrin total te votave.

Asambleja e ortakeve vendos me shumice te cilesuar:

- a) Ndryshimet ne statut.
- b) Rritje dhe zvogelim te kapitalit
- c) Shperndarjen e fitimeve
- d) Prishjen e shoqerise.



Asambleja e ortakeve vendos me shumicen e votave, te ortakeve prezent, per vendimarrje qe kerkojne nje shumice te zakonshme.

Ne kete rast, duhet te jene prezent ne mbledhje, ortaket qe perfaqesojne me shume se 30% (tridhjetë per qind) te kuotave te shoqerise. Asambleja e ortakeve vendos me shumice te zakonshme, per te gjitha vendimet qe nuk kerkojne shumice te cilesuar.

Neni 20 Administrimi

Asambleja e Pergjithshme emerone nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise. Afati i emerimit, nuk mund te jete me i gjate se 5 vjet, me te drejte riperteritje.

Administratori do te ushtroje te gjitha kompetencat e parashikuara nga ligji, pervec atyre qe jane shprehimisht te perjashtuara apo per te cilat duhet miratimi paraprak nga asambleja e pergjithshme.

Znj.Fabiola Zeka, shtetase shqiptare, e datëlindjes 23.04.1990 e lindur ne Tepelene dhe banuese në Tiranë, person madhor me zotësi të plotë për te vepruar, mbajtës e letërnjoftimit nr.036494848 dhe nr.personal J05423077V caktohet si administarore e pare e shoqerise per nje afat 5 vjecar.

Neni 21 Kompetencat e administratorëve

Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- g) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Ne pergjithesi administratori i shoqerise do te kete te drejte dhe kompetence te realizoje te gjitha veprimet per administrimin e zakonshem dhe te jashtezakonshem te shoqerise.

Administratoret janë te detyruar te thërrasin Asamblenë e Pergjitheshme, në rastet kur:
- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 2 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

- shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 2 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 22 **Përgjegjësitë e Administratorit**

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

d) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;

e) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.
Shpërblimi

Neni 23 **Shpërblimi**

Shpërblimit bazë të administratorëve mund t'i bëhen shtesa, që mund të jenë përqindje në fitim ose të ngjashme. Shpërblimet e administratorëve përcaktohen me vendim të zakonshëm të asamblesë së përgjithshme.

Shpërblimi, sipas pikës 1 të këtij neni, duhet të jetë i përshtatshëm dhe në përputhje me detyrat e administratorëve dhe gjendjen financiare të shoqërisë.

Nëse shoqëria është në vështirësi financiare, asambleja e përgjithshme mund të vendosë reduktimin e shpërblimit të administratorëve në masën e përshtatshme.

Kriteret e shpërblimit, shpërblimi individual dhe efekti vjetor i shpërblimit të administratorëve në strukturën e kostove të shoqërisë tregtare publikohen së bashku me pasqyrat financiare vjetore

Neni 24 **Eksperti Kontabel i Autorizuar**

Ne rast se kerkohet nga ligji apo vendoset nga Asambleja e Pergjithshme, kontrolli i bilanceve dhe i librave kontabel te Shoqerise mund ti besohet nje eksperti kontabel te autorizuar, emeruar per 1 (nje) vit.

Eksperti kontabel i autorizuar mund te shkarkohet ne çdo moment sipas menyrave te percaktuara nga legjislacioni ne fuqi.

KAPITULLI IV **VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR,**

Neni 25 **Viti financiar dhe bilanci vjetor**

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

KAPITULLI V **SHPERBERJA DHE LIKUIDIMIN I SHOQERISË**

Neni 26 **Prishja**

Shoqëria priset me ane te nje vendimi te Asamblese se Pergjithshme, me shumicen e kerkuar per ndryshimet e statutit te shoqerise apo nga menytrat e tjera te parashikuara nga ligji.

Neni 27 **Likuidimi**

Ne rast te prishjes Shoqeria do te hape procedurat e likuidimit.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Per te administruar kete proçedure, Asambleja e ortakeve do te emeruje nje ose me shume Likuidatore, te cilet paraqesin raportet perfundimtare mbi gjendjen e aktivitet apo pasivitet te Shoqerise, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohën e nevojshme per te perfunduar likuidimin.

Me perfundimin e proçedures se likuidimit Asambleja do te vendose mbi bilancin financiarë perfundimtare, mbi vlefshmerine e punes se kryer nga likuiduesi dhe mbi perfundimin e proçesit te likuidimit.

Pas pagimit te kreditoreve dhe mbledhjes se kredive, likuidatori/et shperndajne ne fund pjesen e mbetur te aktiveve ortakeve ne proporcion me pjeset e kapitalit te zoteruara prej tyre ne kapitalin themeltar.

Neni 28 **Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.

Neni 29 **Zgjidhja e Mosmarrveshjeve**

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij statuti dhe aktit të themelimit, si dhe ato që mund të lindin në përgjithësi midis ortakëve ose ndërmjet një ose më shumë ortakëve të shoqërisë apo midis shoqërisë dhe paleëve të treta, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe të diskutohen në mënyrë të drejtperdrejte ndërmjet paleve të interesuara.


Në rast të mosarritjes në një marrëveshje në mënyrë miqësore, palet do t'i drejtohet Gjykatës së Tiranës.

Neni 30 **Gjuha**

Ky Statut është hartuar në **4 (katër) kopje** në gjuhën shqipe, dhe u nënshkrua pa vërejtje nga ortakët themelues.

ORTAKËT:

Fabiola Zeka

Fabiola Zeka 

Albana Musaj

Albana Musaj 